

INVESTITORI
“AMV. PPM Petrol” D.O.O.
Leshak, Leposaviq



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PIKËN E FURNZIMIT ME DERIVATE TË
NAFTËS, BENZINËS DHE PLINIT, NGA KOMPANIA “AMV. PPM Petrol” D.O.O., LESHAK KOMUNA
E LEPOSAVIQIT

Leposaviq, Mars - 2026

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PIKËN E FURNZIMIT ME
DERIVATE TË NAFTËS, BENZINËS DHE PLINIT, NGA KOMPANIA “AMV. PPM Petrol”
D.O.O., LESHAK KOMUNA E LEPOSAVIQIT

Ngastra me nr. P-713038079-00293-0, Zona kadastrale Leshak, Komuna e Leposaviqit.

INVESTITORI	
Aplikuesi	Srdjan Biševac
Investitori	“AMV. PPM Petrol” D.O.O.
Adresa:	Kamen, B.b
Lokacioni i Fabrikës	Leshak, Komuna e Leposaviqit
Tel:	+381 66 975 748
Email:	lilo.voca@gmail.com

Investitori:

“AMV. PPM PETROL” D.O.O

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Ms. I Hidrobiologjisë Luljeta Ajdini

Nënshkrimi

Nënshkrimi

luljeta_ajdini@outlook.com

+383 45 805 614

Leposaviq, Mars - 2026

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	5
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	6
3.	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR	7
3.1.	Kategoria e Projektit të Propozuar.....	7
3.2.	Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit	7
3.3.	Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit.....	7
3.4.	Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit.....	8
3.5.	Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme	10
3.6.	Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik.....	11
3.7.	Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave	11
3.8.	Programi kohor i ndërtimit dhe operimit të projektit dhe faza e rehabilitimit pas përfundimit të funksionimit.....	11
3.9.	Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme.....	11
3.10.	Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave.....	12
3.11.	Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin.....	12
3.12.	Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	13
4.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR	14
4.1.	Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti.....	14
4.2.	Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit.....	14
4.3.	Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti	15
4.4.	Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit	16
4.5.	Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë	17
4.6.	Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik	17
4.7.	Karakteristikat natyrore	17
4.8.	Karakteristikat themelore të peizazhit	18
4.9.	Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike.....	18
4.10.	Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike	18
4.11.	Në Zonat me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit	18
5.	GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR	19
5.1.	Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor	19

6.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT	20
6.1.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme	20
6.2.	Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës së propozuar.....	20
6.3.	Vendndodhja ose rruga	21
6.4.	Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut	21
6.5.	Proceset dhe teknologjia e prodhimit	21
6.6.	Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit.....	22
6.7.	Plani i lokacionit.....	22
6.8.	Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit	23
6.9.	Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit 23	
6.10.	Madhësia e lokacionit ose objektit	24
6.11.	Vëllimi i prodhimit	24
6.12.	Kontrolli i ndotjes.....	25
6.13.	Trajtimin e mbeturinave	25
6.14.	Infrastruktura rrugore dhe qasja	25
6.15.	Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit	25
6.16.	Trajnimi	25
6.17.	Monitorimi.....	25
6.18.	Planet për situata emergjente	26
6.19.	Demolimi dhe rehabilitimi.....	26
6.20.	Plani për menaxhimin e mjedisit	26
6.21.	Përshkrimi i alternativës pa veprim	26
7.	PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS	26
7.1.	Ndikimet në ajër	27
7.2.	Ndikimet në tokë	27
7.3.	Ndikimet në ujë	27
7.4.	Ndikimi në peizazh, florë dhe faunë.....	28
7.5.	Ndikimi në nivelet e zhurmës	28
7.6.	Ndikimi social	28
7.7.	Ndikimet nga Mbeturinat.....	28
8.	PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS	29
8.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	29
8.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	30
8.3.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	30
8.4.	Masat për mbrojtje nga zhurma	31

8.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë.....	31
8.7.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë.....	31
9.	PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	32
9.1.	Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis	32
9.2.	Gjendja mjedisore para fillimit të projektit	32
9.3.	Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis	33
9.4.	Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar	33
9.5.	Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera	33
9.6.	Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera	34
9.7.	Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis.....	34
10.	PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR	35
10.1.	Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit	35
10.2.	Pajtushmeria me pëlqim mjedisor	35
10.3.	Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000	36
11.	INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT	36
11.1.	Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,.....	36
12.	BURIMET E TË DHËNAVE.....	37
12.1.	Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së	37

Lista e Figurave

Figura 1.	Pompa e derivateve të naftës, benzines dhe plinit.....	8
Figura 2.	Procesi Teknologjik	10
Figura 3.	Distanca me biznese tjera	13
Figura 4.	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Leposaviqit	14
Figura 5.	Distanca e kompanisë me komunën e Leposaviqit.....	15
Figura 6.	Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi	16
Figura 7.	Distanca e projektit nga lumi Ibër	17
Figura 8.	Kapaciteti i rezervuarve.....	24

1. HYRJE

Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pikën e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O., në Leshak, Komuna e Leposaviqit, bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij raporti është të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore që mund të paraqiten gjatë operimit të aktivitetit, si dhe të përcaktojë masat e nevojshme për parandalimin, reduktimin ose eliminimin e tyre. Aktiviteti përfshin depozitimin e derivateve në rezervuarë nëntokësorë dhe furnizimin e automjeteve përmes pajisjeve shpërndarëse, si dhe operimin e hapësirave shoqëruese brenda kompleksit.

Raporti analizon ndikimet e mundshme në ajër, tokë, ujë, zhurmë, peizazh dhe në aspektin social, duke marrë parasysh karakteristikat e lokacionit dhe kapacitetin e instalimeve ekzistuese. Duke qenë se aktiviteti ka karakter tregtar dhe mekanik, pa procese industriale apo djegie, ndikimet priten të jenë të natyrës lokale dhe të menaxhueshme me zbatimin e masave përkatëse mjedisore. Ky dokument shërben si bazë për vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit me kërkesat mjedisore dhe për sigurimin e një operimi të kontrolluar, të sigurt dhe në harmoni me mjedisin dhe shëndetin publik.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e pikës së frunizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar. Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Ndërtimin Nr. 04 / L-110;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji Nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;
- Ligji nr. 04/l-147 për Ujërat e Kosovës

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim Administrativ (Mmph) Nr.04/2025 për Pëmbajtjen, Metodologjinë dhe Përputhshmërinë e Raportit me Kërkesat Ligjore , Praktikat e Zbatueshme dhe Aspektet e Tjera Teknike Të Raportit
- Udhëzim Administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzim administrativ (qrk) nr. 08 /2016 për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e levizëshme të ndotjes.

Kjo kornizë ligjore dhe nënligjore shërben si bazë për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore që mund të shkaktohen nga operimi i Pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, duke siguruar që projekti të zhvillohet në përputhje me standardet mjedisore dhe kërkesat për mbrojtjen e shëndetit publik.

3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

3.1. Kategoria e Projektit të Propozuar

Projekti për operimin e pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, i zhvilluar nga kompania “AMV.PPM Petrol” në lokalitetin Leshak, Komuna e Leposaviqit, i takon kategorisë së projekteve në fushën e depozitimit dhe tregtimit të karburanteve dhe gazrave të lëngshëm për automjete. Bazuar në natyrën e aktivitetit, projekti përfshin pranimin e derivateve nga cisternat transportuese, depozitimin e tyre në rezervuarë të dedikuar, furnizimin e automjeteve përmes dispenserëve, si dhe menaxhimin e infrastrukturës përcjellëse. Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ky aktivitet i nënshtrohet procedurës së VNM-së për shkak të karakterit të tij potencialisht ndotës dhe rreziqeve që lidhen me depozitimin dhe manipulimin e substancave të ndezshme dhe të rrezikshme për mjedisin.

3.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Duke qenë se pika e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit është e ndërtuar dhe aktualisht në operim, punët përgatitore lidhen kryesisht me përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese, si dhe me përshtatjen e zonave funksionale në përputhje me kërkesat mjedisore dhe të sigurisë. Punët përgatitore përfshijnë kontrollin teknik të rezervuarëve nëntokësorë dhe sistemit të tubacioneve, verifikimin e funksionalitetit të pajisjeve shpërndarëse të karburantit, si dhe kontrollin e sistemit të ventilimit dhe sigurisë në zonën e plinit. Gjithashtu, përfshihet rregullimi dhe mirëmbajtja e platformës së betonuar për furnizim. Në kuadër të këtyre punëve parashihet edhe përditësimi i sinjalistikës së sigurisë, vendosja e shenjave paralajmëruese dhe informative në zonat e rrezikut, kontrolli i pajisjeve kundër zjarrit, si dhe organizimi i zonave për ruajtjen e materialeve absorbente dhe pajisjeve për ndërhyrje në rast derdhjesh aksidentale. Po ashtu, do të realizohen kontrole të instalimeve elektrike, ndriçimit të jashtëm dhe sistemit të tokëzimit, me qëllim sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe të sigurt të pikës së furnizimit. Këto punë përgatitore synojnë të sigurojnë që operimi i pikës së furnizimit të zhvillohet në kushte të kontrolluara teknike dhe mjedisore, duke minimizuar rreziqet e mundshme për ndotje dhe duke garantuar nivel të lartë sigurie për punonjësit dhe përdoruesit e shërbimeve.

3.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Funksionimi i pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. bazohet në një proces të kontrolluar teknikisht, që fillon me pranimin e karburanteve dhe përfundon me furnizimin e automjeteve dhe menaxhimin e

infrastrukturës përcjellëse. Derivatet prahen përmes automjeteve cisternë dhe shkarkohen në rezervuarët nëntokësorë të dedikuar, përmes sistemit të mbyllur të tubacioneve. Rezervuarët janë të pajisur me sisteme matëse për kontrollin e nivelit dhe monitorimin e sasisë së karburantit. Nga rezervuarët, karburanti dërgohet përmes linjave të brendshme deri te pajisjet shpërndarëse, ku realizohet furnizimi i automjeteve. Zona e furnizimit është e betonuar dhe e organizuar në mënyrë funksionale për qarkullimin e automjeteve, me pjerrësi të kontrolluar për drejtimin e ujërave atmosferike drejt sistemit të drenazhimit. Në kuadër të projektit funksionon edhe zona për furnizim me plin, e cila është e pajisur me instalime dhe pajisje sigurie sipas kërkesave teknike për substanca të ndezshme. Procesi i furnizimit me plin realizohet përmes sistemit të mbyllur dhe të kontrolluar, me masa mbrojtëse kundër rrjedhjeve dhe rreziqeve të zjarrit. Funksionimi i përgjithshëm i pikës së furnizimit ka karakter teknik dhe mekanik, me procese të automatizuara për matjen dhe shpërndarjen e karburanteve.



Figura 1. Pompa e derivateve të naftës, benzines dhe plinit

3.4. Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit

Një pompë e derivateve zakonisht i referohet një lokacioni ku automjetet mund të furnizohen me derivate të lëngëta si naftë, benzinë dhe gaz. Procesi teknologjik i punës së pompës së derivateve përfshin disa komponentë dhe procese kryesore. Këtu është një përmbledhje e përgjithshme:

- ✚ **Dorëzimi i derivatit** - Derivatet shpërndahet në rezervuarët e magazinimit me kamionë cisternë. Këta kamionë transportojnë sasi të mëdha derivatit nga rafineritë ose qendrat e shpërndarjes në pompën e derivateve.
- ✚ **Depozitat e ruajtjes së derivatit** – Pompat e derivateve zakonisht kanë rezervuarë nëntokësorë për ruajtjen e derivateve të lëngshëm. Këto tanke janë krijuar për të përmbushur rregullat e sigurisë dhe mjedisit.

- ✚ **Dispensuesit e derivatit** - Shpërndarësit e derivateve janë makinat që pompojnë derivatin në automjete. Ato janë të pajisura me hundë, çorape dhe matës për të kontrolluar me saktësi rrjedhën e derivatit.
- ✚ **Sistemet e pagesave:** pompat moderne të derivateve janë të pajisura me sisteme pagese që lejojnë klientët të paguajnë për derivate. Kjo mund të përfshijë lexuesit e kartave të kreditit/debitit, opsionet e pagesave në celular dhe ndonjëherë transaksione në para.
- ✚ **Sistemet e monitorimit dhe kontrollit** - Për të garantuar siguri dhe funksionim efikas, pompa e derivateve shpesh kanë sisteme monitorimi dhe kontrolli. Këto sisteme mund të përfshijnë sensorë për të zbuluar rrjedhjet, për të matur nivelet e derivateve dhe për të monitoruar gjendjen e përgjithshme të infrastrukturës së derivatit.
- ✚ **Pajtueshmëria rregullatorë** – Pompa e derivateve duhet të jenë në përputhje me rregullore dhe standarde të ndryshme që lidhen me sigurinë, ndikimin mjedisor dhe kontrollin e cilësisë. Inspektimet e rregullta dhe respektimi i udhëzimeve janë thelbësore.
- ✚ **Mirëmbajtja** - e rregullt është thelbësore për funksionimin e qetë të pompës së derivateve. Kjo përfshin kontrollimin e pajisjeve, sigurimin e saktësisë së shpërndarësit dhe trajtimin e menjëhershëm të çdo problemi.
- ✚ **Automatizimi dhe Integrimi** - Disa pompa të derivateve janë të pajisura me sisteme automatizimi dhe integrimi. Kjo mund të përfshijë analizat e të dhënave për të optimizuar menaxhimin e inventarit, furnizimin e automatizuar të derivatit për shërbimet e flotës ose integrimin me sisteme të tjera biznesi.
- ✚ **Ndërveprimi me klientët** – pompat e derivateve shpesh kanë kontakt me klientët për përdoruesit për të zgjedhur llojet e derivatit, për të futur informacionin e pagesës dhe për të marrë faturat. Kontakti miqësorë për përdoruesit përmirësojnë përvojën e përgjithshme të klientit.

Është e rëndësishme të theksohet se funksionet specifike teknologjike mund të ndryshojnë në bazë të nivelit të automatizimit, madhësisë së pompës së derivateve dhe teknologjisë së disponueshme. Për më tepër, përparimet në teknologji mund të çojnë në ndryshime dhe përmirësime në procesin e furnizimit me derivat me kalimin e kohës.




Figura 2. Procesi Teknologjik

3.5. Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Për funksionimin e rregullt të pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzina dhe plini nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. nevojiten burime materiale, energjetike dhe njerëzore, të cilat sigurojnë operim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të aktivitetit.

- **Derivatet e naftës dhe plini** - Burimi kryesor material janë derivate të naftës si nafta dhe benzina, si dhe plini, të cilat furnizohen nga operatorë të licencuar. Sasia e ruajtjes përcaktohet nga kapaciteti i rezervuarëve nëntokësorë të instaluar në lokacion, ndërsa furnizimi realizohet në mënyrë periodike sipas konsumit dhe kërkesës së tregut.
- **Energjia elektrike** - Energjia elektrike përdoret për funksionimin e pajisjeve shpërndarëse, sistemit të monitorimit të rezervuarëve, ndriçimit të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe për pajisjet ndihmëse. Furnizimi me energji realizohet nga rrjeti publik energjetik.
- **Uji** - Uji përdoret për nevoja sanitare dhe për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të kompleksit. Furnizimi realizohet nga pusët private. Sasia e konsumit është e kufizuar dhe lidhet kryesisht me nevoja higjienike dhe pastrim periodik.
- **Burimet njerëzore** - Pika e furnizimit operon me staf të trajnuar për menaxhimin e furnizimit me karburante, realizimin e pagesave dhe zbatimin e masave të sigurisë. Numri i punonjësve përcaktohet sipas organizimit të orarit të punës dhe volumit të aktivitetit.

- **Materialet ndihmëse** - Përdoren materiale absorbente për ndërhyrje në rast derdhesh aksidentale, pajisje për mirëmbajtje teknike dhe mjete për pastrim. Këto materiale ruhen në zona të dedikuara brenda kompleksit.

Në përgjithësi, burimet e nevojshme për funksionimin e pikës së furnizimit janë të karakterit të kontrolluar dhe të menaxhueshëm, ndërsa përdorimi i tyre realizohet në përputhje me kërkesat teknike dhe mjedisore për të minimizuar ndikimet e mundshme në mjedis.

3.6. Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Duke qenë se pika e furnizimit me derivate nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. është e ndërtuar, mbeturinat të cilat mund të krijohen gjatë funksionimit të pompës krijohen vetëm mbeturinat komunale dhe merren nga kompania e kontraktuar për grumbullimin e mbeturinave nga Komuna.

3.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Gjatë operimit të pikës për furnizim me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nuk do të bëhet trjtimi, përpunimi, riciklimi dhe asgjësim i mbeturinave. Mbeturinat komunale që krijohen nga aktivitetet e personelit grumbullohen veçmas dhe merren nga kompania e kontraktuar për grumbullimin e mbeturinave nga Komuna.

3.8. Programi kohor i ndërtimit dhe operimit të projektit dhe faza e rehabilitimit pas përfundimit të funksionimit

Pika e furnizimit me derivate nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. është e ndërtuar dhe në funksion. Faza e ndërtimit ka përfunduar dhe ka përfshirë vendosjen e rezervuarëve nëntokësorë, ndërtimin e platformës së betonuar, instalimin e pajisjeve shpërndarëse, sistemit të drenazhimit dhe pajisjeve kundër zjarrit. Aktualisht nuk parashihen punime të reja ndërtimore, përveç mirëmbajtjes teknike sipas nevojës. Operimi zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, me pranimin periodik të derivateve, depozitimin në rezervuarë dhe furnizimin e automjeteve.

3.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Pika e furnizimit me derivate nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. disponon infrastrukturën e nevojshme për funksionim të sigurt dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe mjedisore.

- **Qasja rrugore dhe sipërfaqet e brendshme** - Lokacioni ka qasje të drejtpërdrejtë në rrugë publike. Hyrje dhe dalje janë të organizuara për qarkullim të kontrolluar të

automjeteve. Zona e furnizimit është e betonuar dhe e projektuar me pjerrësi të përshtatshme për drenazhimin e ujërave atmosferike.

- **Rezervuarët dhe instalimet teknike** - Karburantet ruhen në rezervuarë nëntokësorë të instaluar sipas standardeve teknike. Sistemi i tubacioneve është i mbyllur dhe i lidhur me pajisjet shpërndarëse. Zona e plinit është e pajisur me instalime të posaçme sigurie.
- **Furnizimi me energji elektrike** - Objekti është i lidhur me rrjetin publik të energjisë elektrike, i cili siguron funksionimin e pajisjeve shpërndarëse, ndriçimit dhe sistemeve të monitorimit.
- **Furnizimi me ujë** - Furnizimi me ujë realizohet përmes puseve private. Uji përdoret për nevoja sanitare dhe mirëmbajtje të hapësirave.
- **Ujërat sanitare** – largohën përmes sistemit ekzistues të kanalizimit të fshatit, ndërsa ujërat e shiut duhet të kalojnë në separator të vajrave, pastaj në kanalizim.

Kjo infrastrukturë mundëson operim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të aktivitetit, duke reduktuar rreziqet për mjedisin dhe sigurinë publike.

3.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Pika e furnizimit me derivate nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. është e ndërtuar dhe në operim. Brenda kompleksit funksionon edhe një market shërbimi, i cili ofron produkte të konsumit për klientët e pikës së furnizimit. Marketi operon brenda objektit ekzistues dhe nuk kërkon ndërtim të kampeve, rezidencave apo strukturave të përkohshme. Aktiviteti i tij është i karakterit tregtar dhe gjeneron mbetje komunale në sasi të kufizuar, të cilat menaxhohen përmes shërbimeve publike përkatëse. Nuk parashihen aktivitete shtesë ndërtimore apo zgjerime të reja që do të kërkonin infrastrukturë të përkohshme apo ndërhyrje me ndikim të veçantë mjedisor.

3.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Për operimin e pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, si dhe për funksionimin e marketit brenda kompleksit, investitori është i obliguar të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Lejet dhe licencat kryesore për këtë aktivitet përfshijnë:

1. Legalizimi i objektit, i lëshuar nga Komuna e Leposaviq.
2. Vendimi për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
3. Leja Mjedisore për operimin e aktivitetit.

4. Pëlqimi për Mbrojtje nga Zjarri, i lëshuar nga Agjensioni I Menaxhimit të Emergjencave (AME) (Pajisur)
5. Licenca për tregtimin e derivateve të naftës, benzines dhe plinit, e lëshuar nga Ministria përkatëse e Industrisë dhe Tregtisë.

Kompania aktualisht është në operim. Hartimi i këtij Raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis realizohet për qëllime të përditësimit dhe rregullimit të dokumentacionit mjedisor, në përputhje me kërkesat e autoriteteve kompetente. Të gjitha lejet dhe licencat do të respektohen gjatë gjithë periudhës së operimit, duke garantuar funksionim të rregullt, të sigurt dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

3.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Projekti për pikën e furnizimit me derivate të naftë, benzines dhe pilinit ku në afërsi të parcelës ndodhen edhe disa subjekte me veprimtari të ngjashme dhe të ndryshme ekonomike, ku distancat sipas matjeve në planimetri janë:

- **Biznesi “Europa Pelet”, me distancë rreth 114.06 m**
- **Pompa “WOL GROUP”, me distancë rreth 429.96 m**



Figura 3. Distanca me biznese tjera

4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

4.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Projekti për operimin e pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV. PPM Petrol” D.O.O. zbatohet në lokalitetin Leshak, Komuna e Leposaviqit. Lokacioni i projektit shtrihet në zonën kadastrale Leshak me numër të parces P-71308079-00293-0, sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit kadastral.

4.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Vendndodhja e projektit për operimin e pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV. PPM Petrol” D.O.O. është paraqitur përmes skicës dhe planimetrisë bashkëngjitur, të cilat ilustrjnë pozicionin e lokacionit në nivel rajonal dhe lokal. Në paraqitjen orientuese është evidentuar shtrirja e projektit në territorin e Republikës së Kosovës, me theks në Komunën e Leposaviqit, duke mundësuar identifikimin e saktë të lokacionit në kontekstin gjeografik më të gjerë. Planimetria në nivel komunal dhe lokal paraqet shtrirjen e projektit brenda zonës kadastrale Leshak, ku ndodhet parcela me numër P-71308079-00293-0. Në hartë janë të evidentuara kufijtë e parcelës, pozicioni i pikës së furnizimit në raport me rrjetin rrugor ekzistues, si dhe raporti i saj me hapësirat përreth. Paraqitja grafike ofron një pasqyrë të qartë të vendosjes së projektit në terren dhe lidhjes së tij me infrastrukturën dhe mjedisin përreth, duke shërbyer si bazë për analizën hapësinore në kuadër të këtij raporti.




Figura 4. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Leposaviqit

Në skicat përkatëse është paraqitur gjithashtu lidhja rrugore e lokacionit të projektit me qytetin e Leposaviqit dhe vendbanimet përreth, përmes rrjetit ekzistues rrugor. Kjo lidhje mundëson qasje të rregullt dhe funksionale për furnizimin e pompës me derivate, për qarkullimin e mjeteve gjatë operimit, si dhe për ndërhyrjet e mirëmbajtjes dhe shërbimet teknike, pa pasur nevojë për ndërhyrje të mëdha infrastrukturore.




Figura 5. Distanca e kompanisë me komunën e Leposaviqit

4.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti

Distanca ndërmjet lokacionit të projektit për operimin e pikës së furnizimit me derivatet e naftës, benzin dhe plin, me qendrat e banuara përreth, është vlerësuar në bazë të matjeve hapësinore të paraqitura në planimetrinë përkatëse. Distanca minimale ndërmjet lokacionit të projektit dhe objektit më të afërt të banimit është rreth 229.19 m. Këto distanca krijojnë hapësirë për zbatimin e masave teknike dhe organizative për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe qarkullimit të mjeteve gjatë operimit, me qëllim që ndikimet ndaj banorëve përreth të mbesin të menaxhueshme dhe të kontrollueshme, me kusht që të zbatohen masat e parapara të mbrojtjes mjedisore.



Figura 6. Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi

4.4. Paraqitje e karakteristikat pedologjike, geomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Lokacioni i pikës së furnizimit me derivate nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O., në Leshak, Komuna e Leposaviqit, ndodhet në një zonë me terren të sistemuar dhe të përshtatshëm për aktivitet ekonomik. Nga aspekti pedologjik, parcela është kryesisht e betonuar dhe e modifikuar, prandaj nuk paraqet tokë bujqësore aktive apo vlera të veçanta natyrore. Shtresat sipërfaqësore janë të stabilizuara për shkak të ndërtimeve dhe qarkullimit të vazhdueshëm të automjeteve. Në aspektin geomorfologjik, terreni paraqitet me reliev të butë, pa pjerrësi të theksuara dhe pa rrezik të dukshëm nga rrëshqitjet apo erozioni. Nga pikëpamja gjeologjike, zona përbëhet nga formacione sedimentare dhe materiale aluviale tipike për rajonin verior të Kosovës, të cilat sigurojnë stabilitet të mjaftueshëm për objektet ekzistuese. Në aspektin hidrogeologjik, në afërsi të lokacionit kalon Lumi Ibër, i cili përbën element të rëndësishëm mjedisor në rajon. Për këtë arsye kërkohet kujdes i shtuar në parandalimin e çdo rrjedhjeje apo derdhjeje aksidentale që mund të ndikojë indirekt në ujërat sipërfaqësore apo nëntokësore. Brenda parcelës nuk ka burime ujore, ndërsa rreziku për ndotje lidhet vetëm me situata të jashtëzakonshme. Sa i përket aspektit sizmologjik, territori karakterizohet nga aktivitet sizmik mesatar, tipik për Kosovën. Objektet ekzistuese janë ndërtuar sipas standardeve teknike përkatëse, duke marrë parasysh kërkesat për qëndrueshmëri strukturore.

4.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Për operimin e pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, furnizimi me ujë do të sigurohet nga pusi. Sipas planimetrisë së lokacionit, në afërsi të lokacionit gjenet lumi Ibër në një distancë 211.19m. Ka distancë të mjaftushëm që të mos ketë ndikim në lumë



Figura 7. Distanca e projektit nga lumi Ibër

4.6. Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Lokacioni i pikës së furnizimit me derivate në Leshak, Komuna e Leposaviqit, karakterizohet nga klimë kontinentale me ndikime malore, tipike për rajonin verior të Kosovës. Temperatura mesatare vjetore lëviz rreth 10–11°C. Dimrat janë të ftohtë, me temperatura që shpesh bien nën 0°C, ndërsa verat janë të ngrohta me temperatura që mund të arrijnë mbi 30°C gjatë periudhave të nxehta. Reshjet mesatare vjetore variojnë rreth 700–900 mm, me shpërndarje relativisht të barabartë gjatë vitit, por me intensitet më të lartë në pranverë dhe vjeshtë. Gjatë dimrit janë të pranishme edhe reshjet e borës. Shpejtësia mesatare e erës është e moderuar, me drejtime dominuese që varen nga konfigurimi i terrenit përreth.

4.7. Karakteristikat natyrore

Lokacioni i pikës së furnizimit me derivate ndodhet në një zonë me karakteristika natyrore tipike për rajonin verior të Kosovës. Zona përreth karakterizohet nga reliev kodrinor-malor, me prani të sipërfaqeve të gjelbra, tokave me përdorim të përzier dhe rrjedhës së Lumit Ibër në afërsi, i cili përbën element natyror me rëndësi në rajon. Brenda parcelës së projektit, sipërfaqja është e sistemuar dhe e modifikuar për qëllime funksionale, me mbizotërim të platformave të betonuar dhe infrastrukturës shoqëruese. Nuk janë evidentuar habitate natyrore të mbrojtura apo specie të rralla bimore dhe shtazore brenda kufijve të lokacionit. Karakteristikat natyrore

të zonës përreth kërkojnë kujdes në menaxhimin e aktivitetit, veçanërisht për mbrojtjen e ujërave dhe ruajtjen e pastërtisë së mjedisit, ndërsa brenda parcelës ndikimi në mjedisin natyror është i kufizuar për shkak të përdorimit ekzistues të hapësirës

4.8. Karakteristikat themelore të peizazhit

Peizazhi në zonën e Leshakut, Komuna e Leosaviqit, karakterizohet nga kombinimi i relievit kodrinor-malor, sipërfaqeve të gjelbra dhe rrjedhës së Lumit Ibër në afërsi. Zona përreth paraqet elemente tipike rurale dhe gjysmë-urbane, me ndërthurje të hapësirave natyrore dhe ndërtimeve me funksion ekonomik. Brenda parcelës së projektit, peizazhi është i modifikuar për shkak të infrastrukturës ekzistuese. Sipërfaqet janë kryesisht të betonuar dhe të sistemuara për qarkullim dhe funksionim të aktivitetit, me prezencë të objektit administrativ dhe pajisjeve furnizuese. Aktiviteti nuk ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme strukturën natyrore të peizazhit, pasi zhvillohet brenda një hapësire tashmë të përdorur. Përmirësimi vizual i lokacionit mund të arrihet përmes gjelbërimit të pjesëve të lira të parcelës, duke kontribuar në harmonizimin e tij me mjedisin përreth.

4.9. Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Në zonën ku zhvillohet operimi i pikës së frunizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike brenda parcelave të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre.

4.10. Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike

Sipas të dhënave të përgjithshme të regjistrimeve dhe vlerësimeve statistikore Komuna e Leosaviqit (nga e cila bën pjesë Leshaku) ka rreth 18 600 banorë, me shumicë të popullsisë serbe dhe disa komunitete të tjera që jetojnë në zonë. Zona rreth projektit është e karakterizuar nga një popullsi e shpërndarë në fshatra të ndryshme, pa densitet të lartë urban. Struktura demografike tipikisht përbëhet nga familje lokale që jetojnë dhe punojnë në zonë, me angazhim në aktivitete ekonomike të ndryshme, duke përfshirë bujqësinë, shërbimet dhe tregtinë e vogël.

4.11. Në Zonat me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit

Bazuar në dokumentacionin planifikues në fuqi, gjendjen ekzistuese në terren dhe të dhënat në dispozicion për zonën e Leshakut, Komuna e Leosaviqit, në hapësirën ku zhvillohet operimi i pikës për furnizim me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, nuk janë identifikuar zona me vlera të veçanta shkencore, vende arkeologjike të regjistruara, apo zona veçanërisht të ndjeshme mjedisore brenda parcelës së projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të saj. Në kufijtë

e lokacionit nuk evidentohet prania e rezervateve natyrore ose zonave të mbrojtura me status ligjor, zonave të mbrojtura të biodiversitetit apo zonave të dedikuara për kërkime shkencore.

5. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

5.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Gjendja mjedisore në Komunën e Leposaviqit vlerësohet duke u bazuar në raportet kombëtare të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe publikimet/analizat që trajtojnë në mënyrë të veçantë pellgun e Lumit Ibër dhe çështjet lokale të menaxhimit të mjedisit. Cilësia e ajrit në rajonin verior ndikohet kryesisht nga trafiku rrugor, ngrohja sezonale (sidomos në dimër), si dhe nga burime të tjera lokale (punime, pluhur, aktivitete ekonomike). Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë realizohet përmes rrjetit kombëtar të stacioneve dhe raportohet në baza vjetore. Për Leposaviq shpesh vlerësimi bëhet me referencë edhe te stacionet më të afërta rajonale dhe trendet sezonale (dimri me ngarkesë më të lartë). Elementi më i rëndësishëm ujqor në zonë është Lumi Ibër dhe degët e tij. Gjendja e ujit mund të ndikohet nga shkarkimet komunale, rrjedhjet sipërfaqësore, si dhe nga ndotjet historike/industriale në pellg, prandaj kërkohet kujdes i shtuar në aktivitetet përgjatë luginës së Ibrit. Në literaturë dhe analiza të ndryshme përmenden problematika të ndotjes në Ibër, përfshirë ndikimet nga aktivitetet minerare dhe ndotës të tjerë në pellg. Në aspekt të tokës, ndotjet tipike në komunë lidhen me mbeturina të hedhura në mënyrë të parregullt, derdhje aksidentale nga aktivitete ekonomike dhe ndikime nga infrastruktura rrugore. Në zonat pranë Ibrit, rreziku për ndikim të tokës lidhet edhe me bartjen e ndotësve nga rrjedhat sipërfaqësore drejt lumit. Menaxhimi i mbeturinave komunale mbetet një nga sfidat kryesore në nivel vendi, me probleme të njohura si deponitë ilegale, mbulimi jo i plotë i shërbimit të grumbullimit dhe nevoja për përmirësim të ndarjes në burim. Këto çështje reflektohen edhe në komunat veriore, përfshirë Leposaviqin, sipas raporteve të menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal. Zona e Leposaviqit ka karakter kodrinor-malor me sipërfaqe të gjelbra dhe ekosisteme tipike të rajonit verior. Ndikimet më të shpeshta në biodiversitet lidhen me fragmentimin e hapësirave, presionin nga ndërtimet/rrugët dhe ndotjen e ujërave, sidomos përgjatë Ibrit dhe degëve të tij. Burimi dominues i zhurmës është trafiku rrugor, ndërsa zhurmat industriale janë të lokalizuara dhe varen nga aktivitetet ekonomike në zona të caktuara. Në përgjithësi, zhurma trajtohet si ndikim lokal, me rëndësi më të madhe afër rrugëve kryesore dhe qendrave të aktivitetit.

6. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

6.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Janë shqyrtuar disa alternativa të realizueshme për operimin e pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. në lokacionin ekzistues në Leshak, Komuna e Leposaviqit.

A. Vazhdimi i operimit në lokacionin ekzistues (alternativa e propozuar) - Kjo alternativë parasheh vazhdimin e aktivitetit në parcelën aktuale, duke shfrytëzuar infrastrukturën ekzistuese, rezervuarët nëntokësorë, pajisjet shpërndarëse dhe objektin shoqëruar me market. Kjo zgjidhje mundëson funksionim të qëndrueshëm, pa nevojë për ndërhyrje të reja ndërtimore, duke ruajtur stabilitetin e aktivitetit ekonomik dhe duke kufizuar ndikimet mjedisore në zonë.

B. Ndërprerja e operimit në lokacionin aktual - Kjo alternativë do të nënkuptonte mbylljen e aktivitetit, çmontimin e pajisjeve dhe zbrazen e rezervuarëve. Përveç ndikimit negativ ekonomik dhe social, kjo alternativë do të kërkonte procedura të rehabilitim të plotë të lokacionit, me kosto shtesë dhe pa përfitim të drejtpërdrejtë për komunitetin.

C. Zhvendosja e aktivitetit në një lokacion tjetër - Kjo alternativë do të përfshinte ndërtimin e një pike të re furnizimi në një parcelë tjetër, me investime të reja në infrastrukturë, procedura të reja lejesh dhe ndikime mjedisore shtesë gjatë fazës së ndërtimit. Zhvendosja do të sillte edhe ndërprerje të aktivitetit ekzistues dhe kosto të konsiderueshme financiare.

Pas analizës së alternativave, alternativa më e arsyeshme dhe e realizueshme është vazhdimi i operimit në lokacionin ekzistues, pasi shfrytëzon infrastrukturën aktuale, shmang ndikime të reja ndërtimore dhe siguron vazhdimësi të aktivitetit në përputhje me kërkesat mjedisore dhe ligjore.

6.2. Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës së propozuar

Alternativa e propozuar, që parasheh vazhdimin e operimit të pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit në lokacionin ekzistues në Leshak, vlerësohet si më e përshtatshme sepse siguron balancën më të mirë ndërmjet funksionalitetit teknik, ndikimit të kontrolluar mjedisor dhe kostos ekonomike. Kjo alternativë shfrytëzon infrastrukturën ekzistuese, përfshirë rezervuarët nëntokësorë, pajisjet shpërndarëse, objektin administrativ dhe marketin, duke shmangur nevojën për ndërtim të ri në zona të paprekura. Në këtë mënyrë reduktohen ndikimet shtesë që do të krijoheshin nga ndërhyrjet e reja ndërtimore dhe shfrytëzimi i hapësirave të reja. Lokacioni aktual ka qasje të mirë në rrjetin rrugor ekzistues dhe është i përshtatshëm për zhvillimin e këtij lloji aktiviteti, pasi ndodhet në zonë me karakter ekonomik dhe jashtë zonave të dendura të banimit. Vazhdimi i operimit në parcelën ekzistuese

mundëson menaxhim të kontrolluar të aktivitetit, duke ruajtur sistemet e sigurisë dhe organizimin aktual teknik. Kjo zgjidhje konsiderohet më e qëndrueshme dhe me rrezik më të ulët mjedisor krahasuar me alternativat e zhvendosjes apo mbylljes së aktivitetit.

6.3. Vendndodhja ose rruga

Vendndodhja e projektit në Leshak, Komuna e Leposaviqit, vlerësohet si e përshtatshme për operimin e pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, pasi lokacioni është funksional për këtë lloj veprimtarie dhe ka qasje të rregullt në infrastrukturën ekzistuese rrugore. Pozita e lokacionit mundëson hyrje dhe dalje të organizuar të automjeteve, përfshirë cisternat për furnizim me derivate dhe automjetet e klientëve, duke siguruar qarkullim të kontrolluar dhe të sigurt brenda kompleksit. Organizimi i brendshëm i hapësirës lejon manovrim të përshtatshëm dhe funksionim pa pengesa të aktivitetit.

6.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Sa i përket ujit dhe tokës, ndikimi potencial mund të paraqitet vetëm në rast të rrjedhjeve apo derdhjeve aksidentale të karburanteve. Në kushte normale operimi, nuk ka shkarkime direkte të lëngjeve ndotëse në mjedis. Rezervuarët nëntokësorë dhe sipërfaqja e betonuar e reduktojnë rrezikun e infiltrimit në tokë dhe në ujërat nëntokësore. Në ajër, ndikimi është i përkohshëm dhe lidhet me qarkullimin e automjeteve dhe avullimin minimal gjatë furnizimit me karburant. Këto emetime janë të natyrës lokale dhe nuk paraqesin ndotje të vazhdueshme apo të konsiderueshme. Zhurma gjatë operimit vjen kryesisht nga lëvizja e automjeteve dhe është brenda niveleve të zakonshme për këtë lloj aktiviteti. Sa i përket shëndetit të njeriut, gjatë operimit normal të pikës së furnizimit nuk pritet të ketë ndikime negative apo rrezik për punonjësit dhe klientët, pasi aktiviteti zhvillohet në hapësirë të hapur, me organizim të kontrolluar dhe me respektim të masave teknike dhe të sigurisë në fuqi.

6.5. Proceset dhe teknologjia e prodhimit

Procesi i funksionimit të pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. bazohet në teknologji të kontrolluar për pranimin, depozitimin dhe shpërndarjen e karburanteve. Karburantet pranohen në lokacion përmes kamionëve cisternë nga furnizues të licencuar. Shkarkimi realizohet përmes sistemit të mbyllur të tubacioneve direkt në rezervuarët nëntokësorë të dedikuar për secilin lloj derivati. Rezervuarët janë të pajisur me sistem për matjen e nivelit dhe kontrollin e sasisë, duke mundësuar monitorim të vazhdueshëm të stokut. Nga rezervuarët, karburanti dërgohet përmes linjave të brendshme deri te pajisjet shpërndarëse, ku realizohet furnizimi i automjeteve. Pajisjet janë të pajisura me sistem matës elektronik që siguron dozimin e saktë të sasisë së

furnizuar. Procesi zhvillohet në mënyrë të automatizuar dhe të kontrolluar. Zona për furnizim me plin funksionon me instalime të posaçme teknike dhe sisteme sigurie, në përputhje me kërkesat për substanca të ndezshme. Furnizimi realizohet përmes sistemit të mbyllur, me valvula sigurie dhe mekanizma kontrolli.

Procesi nuk përfshin djegie industriale apo procese kimike prodhuese. Aktiviteti ka karakter kryesisht mekanik dhe tregtar. Ndikimet kryesore potenciale lidhen me avullimin minimal të derivateve gjatë furnizimit, qarkullimin e automjeteve dhe mundësinë e rrjedhjeve aksidentale. Sistemet e monitorimit dhe kontrollit teknik sigurojnë funksionim të qëndrueshëm dhe reduktojnë rrezikun për ndotje të mjedisit, ndërsa mirëmbajtja periodike garanton saktësinë e pajisjeve dhe sigurinë e operimit.

6.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit

Pika e furnizimit me derivate nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. operon në mënyrë të organizuar dhe të kontrolluar, me procedura të qarta për pranimin, depozitimin dhe furnizimin e karburanteve. Gjatë funksionimit zbatohen metoda pune që synojnë sigurinë teknike dhe mbrojtjen e mjedisit. Pranimi i derivateve realizohet sipas procedurave standarde, me kontroll të vazhdueshëm të procesit të shkarkimit nga cisternat në rezervuarët nëntokësorë. Furnizimi i automjeteve kryhet përmes pajisjeve shpërndarëse të mirëmbajtura rregullisht, me monitorim të saktësisë së matjes dhe kontroll teknik periodik. Zbatohen masa për parandalimin e rrjedhjeve aksidentale, përfshirë përdorimin e materialeve absorbente dhe ndërhyrje të menjëhershme në rast derdhjeje. Sipërfaqet e betonuar mirëmbahen në gjendje të rregullt për të shmangur infiltrimin në tokë. Mirëmbajtja teknike e rezervuarëve, tubacioneve, instalimeve elektrike dhe pajisjeve kundër zjarrit realizohet në intervale të rregullta. Personeli është i trajnuar për procedurat e sigurisë dhe reagimin në situata emergjente. Gjatë operimit normal nuk ka procese që gjenerojnë pluhur industrial apo ujëra teknologjike. Emetimet në ajër janë të përkohshme dhe lidhen me qarkullimin e automjeteve. Aktiviteti zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, duke minimizuar çdo ndikim të mundshëm në mjedis.

6.7. Plani i lokacionit

Plani i lokacionit përfshin organizimin funksional të pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, si dhe hapësirat shoqëruese brenda parcelës me numër P-71308079-00293-0 në Leshak. Në plan janë të paraqitura zonat kryesore të aktivitetit, përfshirë pozicionin e rezervuarëve nëntokësorë, pajisjet shpërndarëse të karburantit, zonën për furnizim me plin, si dhe objektin administrativ ku funksionon edhe marketi. Plani përfshin gjithashtu hyrje-daljet nga rruga publike, rrugët e brendshme për qarkullim të automjeteve, hapësirat për manovrim

dhe ndalim gjatë furnizimit, si dhe zonën e parkimit. Organizimi i brendshëm është projektuar në mënyrë që të sigurojë qarkullim të kontrolluar dhe funksionim të sigurt të aktivitetit. Në plan janë të evidentuara edhe hapësirat ndihmëse si ambientet për personel, zona për vendosjen e pajisjeve kundër zjarrit dhe hapësira për grumbullimin e mbetjeve komunale nga marketi dhe aktiviteti administrativ. Furnizimi me energji elektrike, sistemi i brendshëm i instalimeve teknike dhe infrastruktura e drenazhimit janë pjesë e organizimit të lokacionit, duke mundësuar operim të rregullt dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

6.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Pika e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. është e ndërtuar dhe funksionale, prandaj materialet ndërtimore dhe infrastruktura bazë janë tashmë të realizuara. Objekti administrativ dhe platformat e furnizimit janë të ndërtuara kryesisht me beton të armuar dhe elemente metalike, të përshtatshme për ngarkesa nga qarkullimi i automjeteve dhe për qëndrueshmëri afatgjatë. Rezervuarët nëntokësorë për ruajtjen e derivateve janë të përzgjedhur sipas standardeve teknike për substanca të ndezshme, me material rezistent ndaj korrozionit dhe të përshtatshëm për depozitimin e karburanteve. Sistemi i tubacioneve është i realizuar me materiale të posaçme për transport të sigurt të derivateve, duke reduktuar rrezikun e rrjedhjeve. Pajisjet shpërndarëse të karburantit janë të certifikuara për përdorim komercial dhe të pajisura me sisteme matëse elektronike për dozimin e saktë të sasisë. Zona për furnizim me plin është e pajisur me instalime dhe valvula sigurie të përshtatshme për këtë lloj aktiviteti. Materialet e përdorura në realizimin e projektit janë përzgjedhur në funksion të sigurisë teknike, qëndrueshmërisë strukturore dhe minimizimit të rrezikut mjedisor gjatë operimit.

6.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Pika e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. është e ndërtuar dhe në operim, prandaj nuk parashihet fazë e re ndërtimi në kuadër të këtij projekti.

Afati i operimit është afatgjatë dhe varet nga vlefshmëria e lejeve, licencave dhe autorizimeve përkatëse, si dhe nga përmbushja e vazhdueshme e kërkesave ligjore, teknike dhe mjedisore gjatë gjithë periudhës së funksionimit. Aktiviteti do të vazhdojë të operojë për aq kohë sa respektohen kushtet e përcaktuara nga autoritetet kompetente dhe standardet në fuqi.

6.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Madhësia e lokacionit ku zhvillohet operimi i pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit, është e përshtatshme për funksionimin e aktivitetit dhe infrastrukturën përcjellëse, pa pasur nevojë për zgjerime të panevojshme. Sipërfaqja në të cilën shtrihet projekti është 2949 m².

6.11. Vëllimi i prodhimit

Pika e furnizimit me derivate nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. nuk ka proces prodhimi, por funksionon mbi bazën e kapacitetit të depozitimit dhe shpërndarjes së karburanteve. Kapacitetet e rezervuarëve nëntokësorë për derivate të naftës dhe benzines janë si në vijim:

- **R1 = 53068 litra**
- **R2 = 27679 litra**
- **R3 = 27688 litra**
- **R4 = 59277 litra**

Përveç këtyre, në lokacion është i instaluar edhe një rezervuar për plin me kapacitet

- **V_{GLN} = 15 m³.**

Vëllimi real i operimit varet nga qarkullimi ditor i automjeteve, kërkesa e tregut dhe frekuenca e furnizimit me cisterna. Sasia e derivateve që qarkullon gjatë muajit ose vitit ndryshon sipas konsumit, por gjithmonë brenda kufijve të kapaciteteve të depozitimit dhe kushteve të lejes përkatëse. Operimi zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, me monitorim të vazhdueshëm të nivelit të rezervuarëve dhe me furnizim periodik sipas nevojës.



Figura 8. Kapaciteti i rezervuarve

6.12. Kontrolli i ndotjes

Gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate zbatohen masa për parandalimin e ndotjes së ujit dhe tokës, kryesisht përmes rezervuarëve nëntokësorë të sigurt, sipërfaqes së betonuar dhe reagimit të menjëhershëm në rast rrjedhjeje aksidentale. Ndikimet në ajër janë të përkohshme dhe lidhen me qarkullimin e automjeteve, ndërsa zhurma mbetet brenda niveleve të zakonshme për këtë lloj aktiviteti. Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe menaxhimi korrekt i mbetjeve sigurojnë që ndikimet mjedisore të jenë të kufizuara dhe të kontrolluara.

6.13. Trajtimin e mbeturinave

Mbeturinat komunale që krijohen nga personeli do të grumbullohen dhe do të merren nga kompania e kontraktuar nga Komuna.

6.14. Infrastruktura rrugore dhe qasja

Qasja në pikën e furnizimit me derivate në Leshak, Komuna e Leposaviqit, realizohet përmes rrjetit ekzistues rrugor, i cili mundëson hyrje dhe dalje të sigurt të cisternave për furnizim dhe të automjeteve të klientëve. Brenda lokacionit janë të organizuara hapësira për qarkullim të brendshëm, manovrim dhe ndalim gjatë furnizimit, pa pasur nevojë për ndërhyrje të reja infrastrukturore.

6.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit

Kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. është përgjegjëse për respektimin e të gjitha kërkesave mjedisore gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzines dhe plinit, si dhe gjatë funksionimit të marketit brenda kompleksit. Përgjegjësia përfshin zbatimin e masave parandaluese për mbrojtjen e tokës dhe ujërave nga rrjedhjet aksidentale, kontrollin e emetimeve të përkohshme në ajër nga qarkullimi i automjeteve, menaxhimin korrekt të mbetjeve komunale, si dhe mirëmbajtjen e rregullt të rezervuarëve, pajisjeve shpërndarëse dhe instalimeve teknike. Kompania mban evidenca të brendshme për kontrollet dhe mirëmbajtjen periodike, si dhe bashkëpunon me autoritetet kompetente në përputhje me kushtet e lejes mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.

6.16. Trajnimi

Personeli do të trajnohet për përdorimin e pajisjeve, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

6.17. Monitorimi

Monitorimi i parametrave mjedisorë do të realizohet periodikisht, sipas kërkesave ligjore.

6.18. Planet për situata emergjente

Janë parashikuar procedura për reagim në raste emergjente, përfshirë zjarrin dhe ndaljen e pajisjeve.

6.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Në përfundim të zhvillimit të veprimtarisë së operimit, pajisjet do të çmontohen dhe lokacioni do të rehabilitohet, duke rikthyer zonën në gjendje të përafërt me atë para realizimit të projektit.

6.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani përfshin masa parandaluese, monitoruese dhe korrektuese për të gjitha fazat e projektit, me qëllim minimizimin e ndikimeve negative.

6.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim

Alternativa pa veprim nënkupton mosrealizimin e projektit, pa ndikime të reja mjedisore, por edhe pa përfitime ekonomike dhe sociale.

7. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis përfshin analizimin e mënyrës se si operimi i pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. ndikon në komponentët kryesorë mjedisore në lokacionin në Leshak, Komuna e Leposaviqit. Vlerësimi është bazuar në karakteristikat e aktivitetit, gjendjen ekzistuese të zonës dhe legjislacionin në fuqi. Ndikimet janë analizuar në raport me tre aspekte kryesore:

- aspektet fizike dhe kimike, që përfshijnë ndikimet e mundshme në ajër nga qarkullimi i automjeteve, në tokë dhe ujë vetëm në rast rrjedhjesh aksidentale të karburanteve, si dhe zhurmën dhe trafikun brenda lokacionit;
- aspektet biologjike dhe ekologjike, duke marrë parasysh se lokacioni është zonë e shfrytëzuar ekonomisht dhe nuk përfshin habitate natyrore me vlerë të veçantë;
- aspektet socio-ekonomike, që lidhen me ndikimin në komunitetin lokal, sigurinë dhe kontributin në zhvillimin ekonomik të zonës.

Meqenëse aktiviteti ka karakter tregtar dhe mekanik, pa procese industriale apo djegie, ndikimet gjatë operimit vlerësohen si të kufizuara dhe të menaxhueshme. Emetimet në ajër janë të përkohshme dhe lokale, ndërsa rreziku për tokë dhe ujë paraqitet vetëm në situata aksidentale. Qëllimi i këtij vlerësimi është që operimi i aktivitetit të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, në përputhje me kërkesat ligjore dhe me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

7.1.Ndikimet në ajër

Gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate, ndikimet në ajër lidhen kryesisht me procesin e furnizimit dhe me qarkullimin e automjeteve brenda lokacionit. Gjatë furnizimit me benzinë, naftë dhe plin mund të ndodhin avullime të vogla, të cilat çlirojnë komponime organike të avullueshme (VOC) dhe aroma te derivateve. Këto emetime janë të përkohshme dhe ndodhin vetëm gjatë procesit të furnizimit. Qarkullimi i automjeteve të klientëve dhe cisternave për furnizim gjeneron gazra si CO₂ dhe NO_x, të cilat janë tipike për çdo aktivitet me trafik rrugor. Megjithatë, duke qenë se koha e qëndrimit të automjeteve është e shkurtër dhe zona është e hapur, ndikimi në cilësinë e ajrit mbetet lokal dhe i kufizuar. Aktiviteti nuk përfshin procese industriale të djegies apo trajtim të gazrave, dhe nuk ka burime të vazhdueshme industriale të emetimeve. Në kushte normale operimi, ndikimet në ajër vlerësohen si të përkohshme, të lokalizuara dhe brenda niveleve të pranueshme.

7.2. Ndikimet në tokë

Gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate, ndikimet në tokë lidhen kryesisht me mundësinë e derdhjeve aksidentale të karburanteve gjatë furnizimit të automjeteve ose gjatë shkarkimit nga cisternat. Në rast se nuk menaxhohen si duhet, këto derdhje mund të depërtojnë në shtresat e tokës dhe të krijojnë rrezik për ndotje të ujërave nëntokësore. Rezervuarët nëntokësorë për ruajtjen e derivateve përbëjnë një tjetër element me potencial ndikimi në rast të rrjedhjeve të papritura. Megjithatë, në kushte normale operimi dhe me mirëmbajtje të rregullt teknike, rreziku konsiderohet i ulët. Aktiviteti i marketit brenda kompleksit gjeneron mbetje komunale, të cilat nëse nuk grumbullohen dhe largohen rregullisht, mund të ndikojnë negativisht në pastërtinë e tokës dhe në mjedisin përreth. Për këtë arsye, mbetjet menaxhohen në mënyrë të organizuar përmes shërbimeve përkatëse. Në përgjithësi, ndikimet në tokë janë të mundshme vetëm në situata aksidentale ose në rast të menaxhimit jo të duhur, ndërsa gjatë operimit normal ato vlerësohen si të kufizuara dhe të kontrollueshme.

7.3.Ndikimet në ujë

Gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate, ndikimet në ujë lidhen me procesin e ruajtjes dhe shpërndarjes së karburanteve. Rezervuarët nëntokësorë dhe sistemi i tubacioneve paraqesin rrezik potencial vetëm në rast rrjedhjesh apo derdhjesh aksidentale. Nëse do të ndodhte një rrjedhje e pakontrolluar, ekziston mundësia që karburantet të depërtojnë në tokë dhe të ndikojnë në ujërat nëntokësore. Po ashtu, ujërat atmosferike nga zona e furnizimit mund të bartin gjurmë të hidrokarbureve nëse ka derdhje, duke krijuar rrezik për ndotje të ujërave sipërfaqësore. Megjithatë, në kushte normale operimi nuk ka shkarkime të drejtpërdrejta të ujërave të ndotura

në mjedis. Rreziku për ndotje të ujit konsiderohet i lidhur vetëm me situata aksidentale, ndërsa me mirëmbajtje të rregullt dhe kontroll teknik, ndikimet në ujë vlerësohen si të kufizuara dhe të menaxhueshme.

7.4.Ndikimi në peizazh, florë dhe faunë

Duke u bazuar në analizën e ndikimeve në ajër, ujë dhe tokë, ndikimet në peizazh, florë dhe faunë nga operimi i pikës së furnizimit me derivate vlerësohen si të kufizuara. Sipërfaqja është e betonuar dhe e sistemuar, prandaj nuk ka pasur zhdukje të konsiderueshme të vegjetacionit përveç hapësirës së zënë nga objekti dhe platformat funksionale. Sa i përket faunës, duke qenë se zona ka qenë e ekspozuar ndaj qarkullimit të automjeteve dhe aktivitetit ekonomik, nuk është identifikuar prani e zhvilluar e faunës së egër. Për këtë arsye, nuk priten ndikime negative të drejtpërdrejta në specie bimore apo shtazore. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë konsiderohen minimale dhe të kufizuara në hapësirën e lokacionit ekzistues.

7.5.Ndikimi në nivelet e zhurmës

Zhurma paraqet një faktor mjedisor me ndikim potencial në mirëqenien dhe shëndetin e njeriut, veçanërisht në rast të ekspozimit të zgjatur në nivele të larta. Në lokacionin e pikës së furnizimit me derivate “AMV.PPM Petrol” D.O.O., burimet kryesore të zhurmës janë qarkullimi i automjeteve të klientëve, ardhja e autocisternave për furnizim, funksionimi i pajisjeve shpërndarëse. Bazuar në karakterin e aktivitetit dhe në kushtet faktike të lokacionit, niveli i zhurmës është i përkohshëm dhe i lidhur kryesisht me lëvizjen e automjeteve. Vlerësohet se niveli i zhurmës mbetet brenda kufijve të lejuar. Ndikimi nga zhurma konsiderohet i kufizuar dhe nuk paraqet rrezik të konsiderueshëm për mjedisin apo komunitetin përreth.

7.6.Ndikimi social

Operimi i pikës së furnizimit me derivate nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. nuk pritet të ketë ndikime negative të rëndësishme në komunitetin lokal. Aktiviteti zhvillohet në një lokacion ekzistues dhe funksionon brenda parcelës së përcaktuar, pa ndërhyrje në zona të banuara apo hapësira publike. Ndikimet sociale lidhen kryesisht me qarkullimin e automjeteve dhe praninë e klientëve, por këto konsiderohen të zakonshme për këtë lloj veprimtarie dhe nuk paraqesin ngarkesë të veçantë për komunitetin përreth. Nga ana tjetër, aktiviteti ka ndikim pozitiv, pasi siguron furnizim me derivate për zonën, ofron shërbime për qytetarët përmes marketit dhe krijon mundësi punësimi.

7.7.Ndikimet nga Mbeturinat

Gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate dhe marketit gjenerohen sasi të kufizuara mbeturinash, kryesisht mbetje komunale nga aktiviteti ditor dhe në raste të veçanta materiale

të kontaminuara nga ndërhyrjet për pastrim të derdhjeve aksidentale. Mbeturinat grumbullohen në mënyrë të organizuar brenda lokacionit, në kontejnerë të përshtatshëm, dhe largohen rregullisht nga kompania përkatëse e menaxhimit të mbeturinave. Meqenëse mbeturinat menaxhohen në mënyrë të kontrolluar dhe largohen periodikisht, ndikimet në mjedis konsiderohen të menaxhueshme dhe brenda kufijve të pranueshëm.

8. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

Në bazë të analizës së ndikimeve mjedisore nga operimi i pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O., vlerësohet se aktiviteti nuk paraqet rrezik të konsiderueshëm për mjedisin, me kusht që të zbatohen masat mbrojtëse të parapara. Aktiviteti ka karakter mekanik dhe tregtar, pa procese industriale apo djegie. Ndikimet kryesore lidhen me mundësinë e rrjedhjeve aksidentale të karburanteve, emetimet e përkohshme në ajër nga qarkullimi i automjeteve, zhurmën dhe menaxhimin e mbeturinave. Masat kryesore përfshijnë:

- mirëmbajtje të rregullt të rezervuarëve nëntokësorë, pajisjeve shpërndarëse dhe sistemit të tubacioneve,
- reagim të menjëhershëm në rast derdhjeje përmes përdorimit të materialeve absorbente,
- mbajtje të sipërfaqeve të betonuar të pastra dhe në gjendje të rregullt,
- organizim të kontrolluar të qarkullimit të automjeteve brenda lokacionit,
- mirëmbajtje të pajisjeve kundër zjarrit dhe sistemeve të sigurisë,
- grumbullim dhe largim të rregullt të mbetjeve komunale dhe dorëzim të mbetjeve të rrezikshme tek operatorë të autorizuar.

Këto masa do të zbatohen vazhdimisht gjatë operimit, me qëllim parandalimin, reduktimin ose eliminimin e ndikimeve në ajër, tokë, ujë, zhurmë dhe në komponentët e tjerë të mjedisit, duke garantuar funksionim të sigurt dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të reduktuar ndikimet në ajër gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate do të zbatohen këto masa:

- Furnizimi i automjeteve do të kryhet në mënyrë të kontrolluar, duke shmangur derdhjet dhe avullimet e panevojshme.
- Pajisjet shpërndarëse dhe rezervuarët do të mirëmbahen rregullisht për të parandaluar rrjedhje.

- Do të shmanget qëndrimi i gjatë i automjeteve me motor të ndezur brenda lokacionit.
- Në periudha me pluhur do të bëhet lagia e sipërfaqeve për të parandaluar ngritjen e pluhurit nga qarkullimi.
- Të realizohet gjelbërimi i pjesëve të lira të parcelës me mbjellje bari dhe bimësi dekorative, në mënyrë që të reduktohet përhapja e pluhurit dhe të përmirësohet mikroklima e lokacionit.

8.2.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të reduktuar ndikimet në tokë gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate do të zbatohen këto masa:

- Rezervuarët nëntokësorë dhe linjat e tubacioneve do të kontrollohen dhe mirëmbahen periodikisht për të parandaluar rrjedhje.
- Zona e furnizimit dhe hapësirat përreth do të jenë të betonuar dhe në gjendje të rregullt për të shmangur infiltrimin e karburanteve në tokë.
- Në rast derdhjeje aksidentale do të bëhet pastrim i menjëhershëm me materiale absorbente dhe largim i materialit të kontaminuar nga operatorë të autorizuar.
- Mbeturinat komunale do të grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm dhe do të largohen rregullisht.
- Do të zbatohet kontroll i vazhdueshëm i sipërfaqeve për të identifikuar dhe trajtuar çdo shenjë ndotjeje në kohë.

8.3.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për të parandaluar dhe reduktuar ndikimet në ujë gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate do të zbatohen këto masa:

- Rezervuarët nëntokësorë dhe tubacionet do të kontrollohen dhe mirëmbahen rregullisht për të parandaluar rrjedhje.
- Zona e furnizimit do të jetë e betonuar dhe e sistemuar në mënyrë që të shmanget infiltrimi i derivateve në tokë.
- Në rast derdhjeje aksidentale do të bëhet ndërhyrje e menjëhershme me materiale absorbente dhe pastrim i plotë i sipërfaqes.
- Duhet të instalohet dhe mirëmbahet separator për vajra dhe hidrokarbure, në mënyrë që ujërat atmosferike nga zona e furnizimit të trajtohen para se të shkarkohen, duke parandaluar ndotjen e ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore.

8.4.Masat për mbrojtje nga zhurma

Gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate nga kompania “AMV. PPM Petrol” D.O.O. nuk gjenerohet zhurmë e konsiderueshme. Burimet kryesore të zhurmës lidhen me qarkullimin e automjeteve të klientëve dhe ardhjen e cisternave për furnizim. Niveli i zhurmës mbetet brenda kufijve të lejuar për aktivitete të këtij lloji. Për të minimizuar çdo ndikim të mundshëm do të zbatohen këto masa:

- Do të kufizohet koha e qëndrimit të automjeteve me motor të ndezur gjatë furnizimit.
- Automjetet gjatë furnizimit duhet të jenë të fikura.
- Pajisjet shpërndarëse dhe agregati rezervë do të mirëmbahen rregullisht për të shmangur zhurma të panevojshme.
- Qarkullimi brenda lokacionit do të organizohet në mënyrë të kontrolluar për të shmangur lëvizjet e panevojshme.
- Do të respektohen të gjitha kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore për kufijtë e lejuar të zhurmës.

Këto masa sigurojnë që ndikimi nga zhurma të jetë minimal dhe brenda normave të pranueshme.

8.5.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Lokacioni ku operon pika e furnizimit me derivate nga kompania “AMV. PPM Petrol” D.O.O. nuk paraqet habitat natyror me vlerë të veçantë dhe aktiviteti nuk ka ndikim të konsiderueshëm negativ në peizazh, florë dhe faunë. Megjithatë, për të përmirësuar aspektin vizual dhe për të kontribuar në përmirësimin e mikroklimës, kompania do të realizojë gjelbërimin e sipërfaqeve të pa betonuar me mbjellje bari dhe drunj dekorativ. Këto masa ndihmojnë në reduktimin e përhapjes së pluhurit, përmirësimin estetik të lokacionit dhe krijimin e një ambienti më të rregullt dhe më të harmonizuar me mjedisin përreth.

8.7. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Për të minimizuar çdo ndikim të mundshëm në vendbanime dhe popullatë, kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. do të zbatojë këto masa:

- Kufizim të qëndrimit të automjeteve me motor të ndezur gjatë furnizimit.
- Mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve për të parandaluar rrjedhje, erëra apo situata që mund të shqetësojnë komunitetin.
- Mbajtje të pastërtisë së vazhdueshme në lokacion dhe në hapësirat përreth.
- Zbatim të plotë të masave të sigurisë kundër zjarrit dhe trajnime për personelin për reagim në raste emergjente.

9. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

9.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim sigurimin e kontrollit të vazhdueshëm të operimit të pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O., me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi. Monitorimi synon identifikimin në kohë të çdo ndikimi të mundshëm negativ dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese në rast të devijimeve nga kushtet e lejuara. Monitorimi do të realizohet gjatë operimit të rregullt të aktivitetit, me fokus në:

- kontrollin periodik të rezervuarëve nëntokësorë dhe tubacioneve për të parandaluar rrjedhje,
- monitorimin e gjendjes së sipërfaqeve të betonuar për të shmangur ndotjen e tokës,
- kontrollin e funksionimit të separatorit për vajra dhe hidrokarbure,
- vëzhgimin e niveleve të zhurmës gjatë operimit,
- menaxhimin dhe evidencën e mbetjeve komunale dhe mbetjeve të rrezikshme,
- mirëmbajtjen e pajisjeve shpërndarëse dhe sistemeve të sigurisë.

Ky program siguron që operimi i aktivitetit të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat mjedisore gjatë gjithë periudhës së funksionimit.

9.2. Gjendja mjedisore para fillimit të projektit

Gjendja mjedisore para operimit të pikës së furnizimit me derivate në Leshak, Komuna e Leposaviqit, karakterizohet nga një zonë e përdorur për aktivitete të zakonshme dhe me infrastrukturë ekzistuese rrugore. Lokacioni nuk përbënte hapësirë natyrore të paprekur dhe nuk është identifikuar si zonë me vlera të veçanta ekologjike. Në aspektin e ajrit, gjendja ishte e ndikuar kryesisht nga qarkullimi i automjeteve në rrugët përreth. Nuk janë evidentuar burime industriale të ndotjes në lokacion para fillimit të aktivitetit. Sa i përket tokës, parcela ishte e sistemuar dhe e përdorur për qëllime funksionale, pa prezencë të vegjetacionit të zhvilluar apo habitateve natyrore me rëndësi të veçantë. Në aspektin e ujërave, zona nuk karakterizohet nga burime ujore brenda parcelës. Gjendja ekzistuese shërben si bazë krahasuese për vlerësimin e çdo ndryshimi të mundshëm gjatë operimit të aktivitetit. Në përgjithësi, gjendja mjedisore para fillimit të projektit konsiderohet tipike për një zonë me përdorim të zakonshëm, pa ndjeshmëri të lartë mjedisore.

9.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Për aktivitetin e pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O., parametrat kryesorë që do të monitorohen përfshijnë:

- cilësinë e ajrit, me fokus në emetimet e përkohshme nga qarkullimi i automjeteve dhe avullimet gjatë furnizimit;
- nivelet e zhurmës nga qarkullimi i automjeteve, funksionimi i pajisjeve shpërndarëse dhe agregatit rezervë;
- gjendjen e tokës brenda lokacionit, sidomos në zonën e furnizimit dhe në pikat ku mund të ndodhin derdhje aksidentale;
- gjendjen dhe funksionimin e rezervuarëve nëntokësorë, tubacioneve;
- menaxhimin e mbetjeve komunale dhe të mbetjeve të mundshme të rrezikshme;
- gjendjen teknike dhe sigurinë e pajisjeve për të shmangur defekte që mund të shkaktojnë rrjedhje apo ndotje.

Monitorimi i këtyre parametrave mundëson vlerësimin e vazhdueshëm të ndikimeve mjedisore dhe ndërmarrjen në kohë të masave korrigjuese, në mënyrë që ndikimet të mbeten të kontrolluara dhe brenda kufijve të lejuar.

9.4. Vendet, mënyra dhe shpeshësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Matjet dhe kontrollimet do të kryhen brenda lokacionit të pikës së furnizimit me derivate, kryesisht në zonën e furnizimit, pranë rezervuarëve nëntokësorë, në hapësirat e qarkullimit dhe në zonën ku do të vendoset separatori për vajra dhe hidrokarbure. Sipas nevojës, kontrolli mund të shtrihet edhe në kufijtë e parcelës. Gjatë operimit të rregullt, monitorimi do të realizohet në intervale periodike përmes kontrolleve rutinë teknike dhe inspektimeve vizuale. Kontrolli i rezervuarëve, tubacioneve dhe pajisjeve shpërndarëse do të bëhet rregullisht, ndërsa nivelet e zhurmës dhe gjendja e ajrit do të vlerësohen sipas nevojës ose në rast ankese. Matjet, kur kërkohen nga legjislacioni apo kushtet e lejes mjedisore, do të realizohen me pajisje të përshtatshme dhe nga operatorë ose laboratorë të autorizuar, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

9.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e krvera

Raportet e monitorimit do të përfshijnë rezultatet e matjeve dhe kontrolleve të kryera për pluhur, zhurmë, ujëra (pas funksionimit të separatorit), tokë dhe menaxhimin e mbeturinave, si dhe analizën e të dhënave dhe krahasimin me vlerat kufitare të lejuara. Nëse paraqiten devijime, raportet do të përfshijnë edhe rekomandime për masa korrigjuese/shtesë. Dorëzimi i raporteve

do të bëhet në baza periodike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe kushteve të përcaktuara nga autoritetet kompetente për lejen mjedisore.

9.6.Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Pika e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit “AMV.PPM Petrol” D.O.O është e detyruar të sigurojë transparencë dhe të informojë publikun për rezultatet e monitorimit mjedisor, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e lejes mjedisore. Informimi do të realizohet përmes raporteve zyrtare që i dorëzohen autoriteteve kompetente dhe, kur kërkohet, përmes njoftimeve publike ose formave të tjera të komunikimit të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse.

9.7.Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis

Duke qenë se lokacioni i pikës së furnizimit me derivate ndodhet rreth 6 km nga kufiri me Serbinë, është vlerësuar mundësia e ndikimeve ndërkufitare. Bazuar në natyrën e aktivitetit, i cili ka karakter lokal dhe përfshin vetëm depozitim dhe shpërndarjen e derivateve brenda parcelës, nuk priten ndikime ndërkufitare në ajër, ujë apo tokë. Nuk ka procese industriale, shkarkime në trupa ujorë ndërkufitare apo emetime të vazhdueshme që mund të përhapen në distanca të gjata. Megjithatë, në kuadër të programit të përgjithshëm të monitorimit, kompania do të:

- mbajë kontroll të rregullt të rezervuarëve dhe instalimeve për të parandaluar çdo ndotje të mundshme,
- monitorojë funksionimin e separatorit dhe gjendjen e sipërfaqeve,
- raportojë çdo situatë të jashtëzakonshme tek autoritetet kompetente sipas kërkesave ligjore.

për shkak të distancës dhe karakterit lokal të aktivitetit, nuk kërkohet program i veçantë ndërkufitar monitorimi, pasi nuk identifikohen ndikime që mund të kalojnë kufirin shtetëror.

10. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

10.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani i Menaxhimit Mjedor synon të sigurojë mbrojtje efektive të mjedisit gjatë operimit të pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O., si dhe në rast të ndërprerjes së aktivitetit. Gjatë operimit, fokusi do të jetë në funksionimin e sigurt dhe të kontrolluar të rezervuarëve nëntokësorë, pajisjeve shpërndarëse dhe instalimeve teknike. Do të zbatohet mirëmbajtje e rregullt për të parandaluar rrjedhje, kontroll i vazhdueshëm i sipërfaqeve të betonuar. Po ashtu do të menaxhohen në mënyrë të rregullt mbeturinat komunale dhe çdo mbetje tjetër e krijuar nga aktiviteti. Në rast të situatave emergjente, do të zbatohen procedura të qarta për reagim të shpejtë, me pajisje dhe materiale të dedikuara për ndërhyrje. Në rast të përfundimit ose ndërprerjes së aktivitetit, do të realizohet zbrastje dhe pastrim i rezervuarëve, çmontim i pajisjeve sipas standardeve teknike dhe rehabilitim i lokacionit, në mënyrë që zona të lihet në gjendje të sigurt dhe të qëndrueshme nga aspekti mjedor.

10.2. Pajtushmeria me pëlqim mjedor

Zbatimi dhe operimi i pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. do të bëhet në përputhje të plotë me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pëlqimin mjedor, si dhe me legjislacionin mjedor në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse. Kompania është përgjegjëse për respektimin e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga pëlqimi mjedor, duke përfshirë:

- zbatimin e masave mbrojtëse për parandalimin e ndotjes së ajrit, tokës dhe ujërave;
- monitorimin periodik të gjendjes së rezervuarëve, pajisjeve dhe separatorit pas instalimit;
- menaxhimin e rregullt të mbeturinave;
- raportimin pranë institucioneve kompetente sipas kërkesave ligjore;
- bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse dhe inspektuese.

Çdo ndryshim eventual në kapacitet, infrastrukturë apo mënyrë operimi do të trajtohet sipas procedurave ligjore dhe do të njoftohen autoritetet kompetente, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

10.3. Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore, kompania synon zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit mjedisor, në përputhje me parimet e standardit ISO 14000. Zbatimi i këtij sistemi do të kontribuojë në:

- identifikimin dhe kontrollin sistematik të ndikimeve mjedisore;
- përmirësimin e efikasitetit operativ;
- rritjen e përgjegjësisë mjedisore të personelit;
- përmbushjen më të lartë të kërkesave ligjore dhe institucionale.

Zhvillimi i sistemit të menaxhimit mjedisor do të realizohet në mënyrë graduale, duke u përshtatur me natyrën dhe shkallën e aktivitetit të projektit.

11. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

11.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,

Operimi i pikës së furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit nga kompania “AMV.PPM Petrol” D.O.O. është trajtuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe udhëzimet përkatëse në fuqi, me qëllim që të sigurohet një vlerësim i plotë dhe realist i ndikimeve mjedisore. Karakteristikat kryesore që kanë ndikuar në përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së këtij raporti janë: fakti që objekti është i ndërtuar dhe në funksion, natyra e aktivitetit që konsiston në depozitimin dhe shpërndarjen e karburanteve, kapaciteti i rezervuarëve nëntokësorë, organizimi i brendshëm i lokacionit, prania e marketit brenda kompleksit. Projekti nuk përfshin procese industriale prodhuese apo djegie, ndërsa ndikimet kryesore mjedisore janë të natyrës lokale dhe lidhen me mundësinë e rrjedhjeve aksidentale, emetimet e përkohshme në ajër nga qarkullimi i automjeteve, zhurmën dhe menaxhimin e mbeturinave. Informacionet shitesë të përfshira në këtë raport synojnë të sigurojnë përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe të mundësojnë një vlerësim të qartë të ndikimeve, si dhe përcaktimin e masave adekuate për mbrojtjen e mjedisit gjatë operimit afatgjatë të aktivitetit.

12. BURIMET E TË DHËNAVE

12.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- *TE DHËNAT NGA INVESTITORI*
- *Kosovo Geoportal*
- *Leposaviq, 43500 to 43.1827423, 20.7255693 - Google Maps*
- *LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR.04/2025 PËR PËMBAJTJEN, METODOLOGJINË DHE PËRPUTHSHMËRINË E RAPORTIT ME KËRKESAT LIGJORE, PRAKTIKAT E ZBATUESHME DHE ASPEKTET E TJERA TEKNIKE TË RAPORTIT*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 13/2013 PËR KATALOGUN SHITETËROR TË MBETURINAVE*